



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 206, Datë 18.12.2017

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN  
“RREGULLORES MBI KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME  
GAZ NATYROR PËR KLIENËT FUNDORË”.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 16 pika 10 të Ligjit nr.102 /2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e rregullores “Për kushtet e përgjithshme, në shërbimin e furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatohet se:**

- Neni 16, i Ligjit nr. 102/2015” Për Sektorin e Gazit Natyror” në pikën 10 të tij përcakton si përgjegjësi të ERE-s, miratimin e kushteve të përgjithshme të furnizimit, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendos:**

1. Të filloj procedurën për miratimin e “Rregullores për kushtet e përgjithshme në shërbimin e furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundor ”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, do të njoftojë të gjitha palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohej në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike, nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit AHMETI**